REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 47/17
Datë/Datum 15.03.2017
PRISHTINE - PRIŠTINA

Republika e Kosovës

Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

AKT PËRCJELLËS

Për:	Menaxherin e prokurimit **Komuna Gjilan**	Kopje:	Paneli Shqyrtues - OSHP
Prej:	Visar Basha – Ekspert shqyrtues i prokurimit		
Lënda:	Ekspertiza lidhur me Ankesën Nr. **47/17** e OE **"Albkos International"** – Fushë Kosovë.		
Datë:	15.03.2017		

Bazuar në nenin 114 të Ligjit Nr. 04/L-042 të Prokurimit Publik të Kosovës ju njoftojmë me raportin e ekspertizës, lidhur me ankesën e parashtruar me dt: 16.02.32017 me Nr. **47/17** nga OE **"Albkos International"** – Fushë Kosovë, për shqyrtimin e lëndës: **"Furnizim me pajisje të aksidenteve të komunikacionit rrugor për nevoja të zjarrfikësve"** me numër të prokurimit GL651/16/074/121, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **Komuna Gjilan.**

AK është i thirrur që pas marrjes së raportit të ekspertit shqyrtues lidhur më këtë kërkesë, të veprojë sipas kërkesave të nenit 115 të LPP-së.

Të bashkangjitur gjeni raportin e ekspertit shqyrtues.

Ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – **KOMUNA GJILAN.**
- Panelit Shqyrtues – **OSHP.**
- OE ankues – **ALBKOS.**

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

		07.03.2017		**07.03.2017**		**15.03.2017**
Nënshkrimi i ekspertit		*Data e autorizimit të eksp.*		*Data e fillimit të ekspertizës*		*Data e dorëzimit të raportit*

N. 105, LPP - Baza ligjore e shqyrtimit

Me datën 16.02.2017, Organi Shqyrtues i Prokurimit ka pranuar ankesën me nr. **47/17** e parashtruar nga OE **"Albkos International"**, me seli në Fushë Kosovë, lidhur me aktivitetin e prokurimit: **"Furnizim me pajisje të aksidenteve të komunikacionit rrugor për nevoja të zjarrfikësve"** me numër të prokurimit GL651/16/074/121, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – **Komuna Gjilan.**

Konform nenit 113 te Ligjit Nr. 04/L-042, Eksperti Shqyrtues e ka shqyrtuar dhe analizuar lëndën e (AK) – **Komunës së Gjilanit (KGJ).**

N.111 i LPP-së - Operatori Ekonomik Ankues "Albkos International", me seli në Fushë Kosovë.

Pikat e Ankesës nga OE **"Albkos International"** *- dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues:*

Neni 7 – Barazia në trajtim / jo Diskriminimi;
Neni 53 – Sigurimi i informatave shtesë për kandidatët dhe tenderuesit;
Neni 54 – Njoftimi i kandidateve dhe tenderuesve të eliminuar;
Neni 59 – Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve.

Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet:

Pas pranimit te dosjes se tenderit me date: 22.11.2016, kemi konstatuar qe ne përshkrim teknik ka disa paqartësi, prandaj me date: 22.11.2016 kemi kërkuar sqarime me shkrim prepozicionet e paqarta (shih dokumentin e bashkangjitur Aneksi 5), megjithatë AK nuk ka dërguar te dhënat përkatësisht sqarimet e kërkuara duke shkelur nenin 53 te LPP-se - Sigurimi i informatave shtesë për kandidatët dhe tenderuesit.

Pavarësisht kësaj, ne kemi konkurruar ne mënyrë te rregullt dhe deri me 01.02.2017, kur ne ueb faqen e KRPP-se, kemi pare njoftimin për nënshkrimin e kontratës dhe nuk kemi pasur asnjë informacion lidhur me këtë aktivitet te prokurimit, duke vepruar ne kundërshtim me nenin 54 - Njoftimi i kandidateve dhe tenderuesve të eliminuar.

Edhe pse kemi dërguar kërkesën për rishqyrtim prapë nuk kemi marr përgjigje, për këtë arsye ju kemi drejtuar departamentit te monitorimit te tenderëve pran KRPP-se, nga te cilët kemi marr shkesën ku na drejtojnë qe te parashtrojmë ankesë pran OSHP-se. Duke pasur parasysh te gjitha këto shkelje ligjore te AK-se, kerkojm qe te anulohet vendimi i AK-se dhe lënda te kthehet ne Ri-vlerësim dhe te përmbushën konditat ligjore te LPP-se.

Procesi i prokurimit:

Data e njoftimit për kontratë në KRPP : 15.11.2016

Lloji i procedurës së aplikuar:..... Procedurë e hapur

Lloji dhe vlera e kontratës së publikuar: .....Furnizim/vlerë e mesme

Afati i fundit për dorëzimin e ofertave (gjithsejtë ditë): 25.11.2016

Data e hapjes së ofertave .....25.11.2016-15:30^{h}

Kriter për dhënie të kontratës:.....*Tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët*

Lloji i kontratës:.....*Kontratë Publike*

Kriteret për vlerësim

III.2)KUSHTET PËR PJESËMARRJE

III.2.1)Kërkesat e përshtatshmërisë:

1. Deklarata nën betim, Zotimin e OE se i plotëson kërkesat për të konkurruar sipas Ligjit 04/L-042, Neni 65
2. Dëshminë se operatori ekonomik në fjalë nuk është me vonesë për pagimin e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit para dorëzimit të tenderit.
3. Dheshmi nga Gjykata që operatori nuk eshte i denuar apo nen hetime

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

1. Deklarata nën betim që tenderuesi i plotëson kërkesat për të konkurruar sipas Ligjit 04/L-042, Neni 65 e nënshkruar dhe vulosur për secilin partner të një grupi operatorësh ekonomik(**formularin që është pjesë dosjes së tenderit**).
2. Një vërtetim i lëshuar nga administrata tatimore e vendit të themelimit të operatorit ekonomik, se operatori ekonomik në fjalë nuk është me vonesë për pagimin e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit para dorëzimit të tenderit (apo të ketë marrëveshtje me ATK-n për riprogramim të borgjit) - ***për operatorin ekonomik i cili propozohet të shpërblehet me kontrat duhet të dorëzoj origjinalin***

Vertetimin nga Gjykata qe operatori nuk eshte i denuar apo nen hetime

III.2.2)Përshtatshmëria profesionale:

1. Certifikata e biznesit me letrat përcjellese dhe te ketë kodin e veprimtaris përkatëse
2. Certifikata e Nr fiskal

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

1. Certifikata e biznesit me letrat përcjellese dhe te ketë kodin e veprimtaris përkatëse**Kopje**
2. Certifikata e Nr fiskal kopje **Kopje**

III.2.3)Kapaciteti ekonomik dhe financiar

III.2.4)Kapaciteti teknik dhe profesional

1. Paisjet duhet te jene ne baze te standarteve EN
2.Ofertuesi duhet te jete i autorizuar nga prodhusi per shitje
3.Garancioni i Prodhuesit

Dëshmia e kërkuar dokumentare

1.Certifikata EN per secilin produkt te paraqitur ne specifikacion Teknik
2. Autorizimin e prodhuesit per shitje te produkteve ose distributor i autorizuar
3.Deklarata e Prodhuesit per garancion dhe servisim të paisjve ne rast nevoje.

Regjistri i ofertuesve sipas procesverbalit të hapjes publike:

Nr	Operatoret ekonomik	Vendi	Çmimi total për njësi €	Vërejtje
1.	"Tekniku"	Gjakovë	36,152.08€	JO
2.	"Albkos"	Fushë Kosovë	36,441.90€	JO
3.	"Pastor Kosova"	Prishtinë	34,055.42€	JO

Komisioni vlerësues pranë AK:

Përbërja dhe kualifikimi i komisionit vlerësues.

Autoriteti Kontraktues për vlerësimin e tenderëve ka caktuar komisionin në përbërje prej tre anëtarëve, si në vijim:

- - Kryetar i komisionit
- - Anëtar i komisionit
- - Anëtar i komisionit

Data e mbarimit të vlerësimit: 00.00.0000

Data e nënshkrimit te raportit nga zyrtari kryesor i prokurimit:..... 00.00.0000

Data e njoftimit të Dhënies së Kontratës në faqen e Krpp-së :..... 00.00.0000

Sipas raportit të komisionit të vlerësimit ofertat të PËRGJEGJSHME janë:

Nr.	Emri i tenderuesit të Përgjegjshëm	Çmimi i ofruar	Radhitja sipas çmimit
1.			
2.			
3.			

Raporti i komisionit vlerësues:

Përgjigjet e ekspertit shqyrtues në lidhje me pretendimet ankimore të OE ankues:

Sqarimi nr.1

Eksperti shqyrtues, fillimisht sqaron se OE ankues, nuk ka pranuar letër standarde nga AK-Komuna e Gjilanit. Eksperti shqyrtues sqaron se mos dërgimi i letrës standarde përben shkelje te nenit 54 te LPP-se.

Ne lidhje me mos dërgimin e letrës standarde AK-ja, ka dhënë arsyetimin se, "për shkak te mbingarkesës se email-it".

Ne ankesën e parashtruar ne OSHP, OE ankues ka pretendime ankimore ne lidhje me shkeljet procedurale pas fazës se vlerësimit, konkretisht për shkak te mosdërgimit te letrës standarde dhe gjithashtu pretendon se ne fazën kritereve kemi pasur paqartësi, ne lidhje me kriteret për te cilën kemi kërkuar sqarime dhe njëherit pretendon se AK-ja, nuk i ka kthyer përgjigje.

Eksperti shqyrtues nuk mund te konstatoj pretendimin e lartpërmendur për faktin se AK-ja, nuk i ka sjell fare dokumentacionin dhe ofertat e OE-ve qe kanë marr pjesë ne këtë aktivitet te prokurimit.

Sqarimi nr.2

Eksperti shqyrtues, ne vazhdim sqaron se pas pranimit te ankesës se OE ankues "Albkos", OSHP-ja ka lëshuar vendimin për pezullim te këtij aktiviteti te prokurimit dhe me datën: 16.02.2017, AK-ja, e ka pranuar vendimin ne fjalë për te cilin sipas dispozitave te LPP-se, AK-ja ka qene e obliguar ta zbatoj dhe ti sjell ne OSHP ofertat e OE-ve pjesëmarrës ne këtë aktivitet te prokurimit dhe dokumentacionin tjetër ne lidhje me këtë aktivitet te prokurimit.

Autoriteti kontraktues – Komuna e Gjilanit, me datën: 20.02.2017, ka dërguar një shkresë – Njoftim, përmes email-it, ne te cilin ka dhënë arsyetimin e pamundësisë se zbatimit te vendimit te pezullimit me nr. 47/17 për aktivitetin e prokurimit: **"Furnizim me pajisje të aksidenteve të komunikacionit rrugor për nevoja të zjarrfikësve",** me numër të prokurimit GL651/16/074/121.

Ne njoftimin e lartpërmendur AK-ja, deklaron se kontrata ne fjalë është nënshkruar me datën: 04.01.2017 me OE "Pastor Kosova" dhe poashtu ka dhënë edhe arsyetimin e mosdërgimit te letrës standarde, siç u përmend edhe me lart.

Sqarimi nr.3

Eksperti shqyrtues, sqaron se fakti qe AK-ja, nuk i ka dërguar letrën standarde OE ankues, i ka mohuar te drejtën e operatorit ekonomik për te ushtruar te drejtat e tij ligjore dhe njëherit sqaroj se OE ankues ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim pran AK-se dhe nuk ka përgjigje – vendim te AK-se ne lidhje me kërkesën për rishqyrtim. Poashtu, siç e kam konstatuar edhe me lart AK-ja, nuk i ka sjellë ofertat dhe dokumentacionin tjetër përcjellës ne OSHP, sipas vendimit për pezullim te aktivitetit te prokurimit. Prandaj, duke u bazuar ne shkeljet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues, sqaron se ky aktivitet i prokurimit duhet te kthehet ne rivlerësim dhe AK-ja, ti respektoj ne tërësi dispozitat e LPP-se.

Mendimi i ekspertit shqyrtues :

- Eksperti shqyrtues bazuar në konstatimet e cekura në ekspertizë mendon që Autoriteti Kontraktues – **Komuna Gjilan**, për aktivitetin e prokurimit **"Furnizim me pajisje të aksidenteve të komunikacionit rrugor për nevoja të zjarrfikësve"** me numër të prokurimit GL651/16/074/121, nuk i ka respektuar në tërësi dispozitat e LPP-së.
- Prandaj eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ta anulojë vendimin e AK-së për dhënie të kontratës dhe propozon që ky aktivitet i prokurimit të **Rivlerësohet** dhe njëherit i propozon panelit shqyrtues qe ankesa e OE ankues te aprovohet si e bazuar.